

Politika e TI-së për dhurimet dhe udhëzimet

Hyrje

Dhurimet dhe të ardhurat e tjera mundësojnë TI-ja të luftojë kundër korrupsionit. TI duhet të sigurojë mjete financiare të duhura për të punuar vazhdimisht. Mjetet e sigurta dhe të shumëllojshme mundësojnë TI-së të ruajë pavarësinë e saj, mbrojtjen e reputacionit të saj dhe punimin efikas.

Historia

Degët kombëtarë dhe Sekretariati (TI-S) finansohen nga burimet të ndryshme: fondacione, agencitë qeveritare, sektori privat, individë, prej anëtarësisë, të ardhurat nga botimet, ngjarjet dhe aktivitete tjera dhe nga fondi për dhurimet. Duke u mbështetur në shumë burime të të ardhurave i ndihmon TI-së të ruajë pavarësinë e saj. Financimin mund të jetë i pakufizuar ose i lidhur me projekte konkrete.

Në përgjithësi, degët kombëtare e TI-S (organet e TI-së) mbledhin mjete financiare vetë. Për sa i përket mbledhjes së mjeteve financiare për Sekretariat, Sektori për marrëdhënie me donatorët i drejton dhe i koordinon aktivitetet për mbledhjen e mjeteve financiare të TI-së. Nënkomiteti të Bordit e TI-së, Grupi punues për mbledhjen e mjeteve financiare, i ndjek dhe i mbikëqyr iniciativat e mëdha për mbledhjen e mjeteve financiare për lëvizjen. Ky komisioni, gjithashtu, i këshillon çdo çështjet në vijim.

TI-ja nuk duhet të rrezikojë reputacionin e vetë për ndershmëri, hapje dhe integritet. Reputacioni mund të kompromitohet nëse trupi i TI-së merr mjete nga burime të cilat konsiderohen se bëjnë aktivitet e të cilat nuk janë në pajtueshmëri me misionin e TI-së.

Politika

Politika e TI-së është të pranojë financimin me para ose në ndonjë formë tjetër, nga secili donori me kusht pranimit të mos: - shkel pavarësinë e TI-së për të kryej misionin e vet, - kërcënon integritetin dhe reputacionin e saj.

Fusha e veprimit

Kjo politikë i referohet të gjithë fondeve për të gjithë organet e TI-së, pavarësisht për cilin donor bëhet fjalë ose për çfarë shume bëhet fjalë: ato aplikojnë në të gjitha aktivitetet rreth mbledhjes së mjeteve nga donatorët ekzistues dhe të gjithë donatorët në të ardhmen. Derisa, ajo nuk referohet në të ardhurat prej shitjes së botimeve ose kompensim për pjesëmarrje në konferenca, ngjarje dhe aktivitete tjera. Gjithmonë duhet të ndërmerren të gjitha masa e nevojshme për të mbrojtur reputacionin e TI-së.

Udhëzime

Finansimet të cilat e mundësojnë funksionimin e të gjitha organeve të TI-së duhet të kërkohen nga një spektër i gjerë burimesh. Duhet të kihet parasysh për finansimin lidhur me projektin të mos rezultojë me ndikime të panevojshme mbi punën dhe programin e TI-M-së. Organet e TI-së mund të pranojnë financimin nga të gjitha llojet e burimeve, për të ruajtur pavarësinë dhe reputacionin.

Çdo organ i TI-së duhet ti citojë të gjitha donacionet mbi 1.000 euro dhe t'i publikojë, edhe në raportin e vitit, edhe në ueb-faqen e saj. Nëse ekziston rrezik i konsiderueshëm se pranimi i mjeteve nga një burim i caktuar do të prishë pavarësinë e TI-së ose nëse lidhur publikisht me donatorin e rrezikon reputacionin e TI-së, atëherë financim nga ai burim nuk duhet të pranohet nga ai organ i TI-së.

Çdo donacion për organin i TI-së duhet të jetë në gjendje që të kundërshtojë shqyrtimin publik. Pavarësia e TI-së kërkon që donatori të jetë subjekt i së njëjtës kritikë nga TI-ja, si çdo organizatë apo individ tjetër në një situatë të ngjashme. Donatori, i cili është akuzuar se është përfshirë në korrupsion, nuk mund të presë ndonjë mbrojtje nga TI-ja.

TI-ja mund të marrë fonde nga korporatat dhe donatorët e sektorit privat. Kjo nuk nënkupton ndonjë miratim të politikave ose të dënave të kompanisë dhuruese. Rekomandohet që kompania potenciale donatore publikisht t'i obligohet mbi standardet etike (siç janë marrëveshja Glabale e KB, parimet e biznesit etj.), parimet e punësimit (Parimet e Biznesit), dhe trupat e TI-së mund të kërkojnë nga dhonorët korporativë të nënshkruajnë përkushtimin e tyre mbi integritetin para se të pranohen çfarëdo lloj donacioni nga ajo kompani.

Asnjë nga trupat e TI-së nuk duhet të pranojë dhurim nga kompani për të cilën është vërtetuar se është lidhur me korrupsionin, përveç nëse kompania dëshmon se kjo ishte shkelja e politikave të kompanisë, se shkelja i këtyre politikave ishte adresuar në mënyrë e duhur, ose se politikat e saj janë ndryshuar për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen. TI-ja punon me kompani të cilat punojnë për të krijuar mjedës pune në të cilit rushfeti nuk është i pranuar.

Është përgjegjësia e secilit punëtor ose anetari të Bordit Drejtues të trupave të TI-Së të sigurojnë që të mos rrezikohet pavarësia dhe reputacioni i TI-së.

Në rast se, çdo punëtor ose anëtar i Bordit Drejtues të trupave të TI-së, dyshon se ekziston një rrezik për pavarësinë dhe reputacionin e TI-së për shkak se donacionet e pranuar, ose donacionet të cilat duhet të jenë i pranuar, ky person duhet të adreson tek personi drejtues ose tek Kryetari i Bordi Drejtues të TI-së.

E miratuar nga ana e AMMM-së. 10.10.2004., Nairobi, Kenia

Përditësuar nga ana e AMM-së, 19.20.104., Berlin, Gjermani.